



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.6422/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Llulluni kryetar, Nora Bllaca-Dula dhe Halide Reka anëtarë, duke vendosur në çështjen kontestimore juridiko-civile, të paditësit R.C. nga Hani i Elezit, të cilin me autorizim e përfaqëson M.K.-B., avokate nga Kaçaniku, kundër të paditurës Kompania e Sigurimit “E...” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson E.A. nga Prishtina me autorizim, për kompensimin e dëmit material, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, C.nr.294/18 të dt.12.10.2020, në seancën e kolegjit e mbajtur me datë 29.07.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimit “E...” me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, C.nr.294/18 i dt.12.10.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I të dispozitivit, miratohet kërkesëpadia e paditësit R.C. nga Hani i Elezit dhe detyrohet e paditura Kompania e Sigurimit “E...”, me seli në Prishtinë, që paditësit të ia paguaj shumën prej 1.710.69€, në emër të dëmit material në automjetin e udhëtarëve VW “Tiguan”, me targë të regjistrimit ...-.... në tërësi si e bazuar. Këtë shumë me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 08.10.2020 (data e seancës kryesore) e deri në pagesën definitive. Me të njëjtin aktgjykim në pikën II të dispozitivit, detyrohet e paditura që paditësit të ia paguaj shumën nga pika I e këtij dispozitivi të aktgjykimit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 891.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj, ashtu që të gjykoj shumat dukshëm me të ulëta.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoj shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës, është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: paditësi përmes të autorizuarës, si në padi dhe në seancat e mbajtura gjyqësore, si dhe precizimin e kërkesëpadiisë ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që t'ia paguaj dëmin material në shumën prej 1.710.69€, në automjetin e udhëtarëve VW "Tiguan", me targë të regjistrimit ...-...-.... Ka theksuar se, ky dëm është shkaktuar me fajin e të siguarit të paditurës, e i cili fakt nuk ishte kontestues mes palëve ndërgjyqëse, fakt i vërtetuar edhe nga provat në shkresat e lëndës. Ndërkaq, sa i përket lartësisë së dëmit, është vërtetuar me ekspertizën e ekspertit S. SH., i cili në ekspertizën e tij ka konstatuar se dëmi i shkaktuar në automjetin e paditësit, është në shumë totale prej 1,710.69€. Ka propozuar që kërkesëpadiia e paditësit të miratohet në tërësi si e bazuar. Shpenzimet i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 7 dhe 8 të LPK-së, ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në fund ka marrë aktgjykimin me të cilin e ka miratuar në tërësi kërkesëpadiinë e paditësit, më decidivisht të përshkruar si në dispozitivin ne aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit, nga gjykata e shkallës së parë theksohet se, me dt.07.02.2018 ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, i shkaktuar me fajin e të siguarit të paditurës, ku dëm material ka pësuar paditësi, të cilit i është dëmtuar automjeti i llojit "Tiguan", dëm ky i cili arrin shumën prej 1,710.69€. Këtë fakt, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar nga thëniet në padi, raportit të policit hetues, ku është shënuar se deri te aksidenti ka ardhur kur njësia A duke lëvizur mbrapa godet njësinë B, e cila ishte duke lëvizur në rrugën "Dëshmoret e Kombit", në Hanë të Elezit, e që nuk ishte kontestues mes palëve, sepse pala e paditur nuk e ka kontestuar bazën e kërkesëpadiisë. Gjykata e shkallës së parë, lartësinë e dëmit të shkaktuar paditësit, e ka vërtetuar me ekspertizën e ekspertit S. Sh., i cili ka konstatuar se dëmi në automjet e arrin shumën prej 1,710.69€, të cilës ekspertizë gjykata ia fali besimin e plotë, sepse e njëjta është punuar në mënyrë profesionale.

Gjykata e shkallës së parë, në gjithë shumën e gjykuar ka caktuar edhe kamatën ligjore për dëmin material duke e bazuar këtë në dispozita përkatës e ligjore të LMD-së, dhe ka vendosur që të aprovoj kërkesëpadiinë e paditësit për dëmin e shkaktuar me aksidentin e komunikacionit të dt.07.02.2018, e po ashtu bazuar edhe në mendimin dhe vlerësimin profesional të ekspertit të makinerisë. Krejt në fund ka vendosur edhe lidhur me shpenzimet e procedurës duke dhënë sqarimet përkatëse, të cekura më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Këtë gjendje faktike të çështjes gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në dispozitat e nenit 7, 8 të LPK-së, neni 136, 159, 169, 382 të LMD-së, si dhe nenit 452.1 të LPK-së dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Prandaj nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës, që gjykata e shkallës së parë ka bërë zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe që shuma e gjykuar të zvogëlohet, pasi që një vendim të tillë gjykata e shkallës së parë e mori bazuar në ekspertizën profesionale të ekspertit të makinerisë S. Sh., të cilin e ka propozuar vet e paditura, në seancën kryesore të dt.04.12.2019. Kështu që mendimin e ekspertit në fjalë edhe Gjykata e Apelit e vlerëson të drejtë, ndërsa shumën e konstatuar si reale.

Pra, Gjykata e Apelit vlerëson se, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë, në harmoni të plotë me arsyetimin e dhënë dhe në të njëjtin janë dhënë arsye konkrete për faktet me rëndësi vendimtare për një vendosje të tillë, e sidomos bazuar në ekspertizën e ekspertit të makinerisë S.SH., i cili në ekspertizën e tij të përpiluar me shkrim të dt.27.01.2020, ka dhënë mendimin dhe vlerësimin e tij profesional, bazuar në dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës dhe ka konstatuar se dëmi material i shkaktuar paditësit në automjetin e tij të tipit “Tiguan” është në shumë totale prej 1,710.69€. Kësaj ekspertize, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ia ka falë besimin e plote ia ka falë besimin e plotë, e të cilën si profesionale e pranon edhe kjo gjykatë.

Andaj, i pa qëndrueshëm është pretendimi ankimor i të paditurës që gabimisht është zbatuar e drejta materiale dhe që shumat janë tepër të larta dhe nuk janë reale me llojin e dëmit, sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vlerësuar dhe arsyetuar lartësinë e dëmit material, dhe atë në pajtueshmëri mendimin profesional të eksperti si dhe me dispozitat përkatëse ligjore.

Prandaj, në këtë aspekt nuk mund të konsiderohet se paditësit i janë caktuar shuma të larta për këtë kategori të dëmit. Krejt këto janë caktuar nga gjykata e shkallës së parë bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar dhe në pajtim me konstatimin dhe mendimin profesional të ekspertit të makinerisë.

Prandaj, edhe Gjykata e Apelit shumë e caktuar të dëmit material të cilin e ka pësuar paditësi në veturën e tij e vlerësoj reale, ndërsa aktgjykimi i atakuar është si rrjedhojë e zbatimit të drejtë të dispozitës së nenit 136 të LMD-së në të cilën dispozitë në mënyrë decisive parashihet se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Kështu ka vepruar edhe gjykata e shkallës së parë, në rastin konkret të paditësit, kur e ka detyruar të paditurën për kompensimin e dëmit material paditësit, në shumën e cekur si në ekspertizën e makinerisë, të punuar lidhur me rastin konkret.

Gjykata e Apelit i vlerësoi pretendimet ankimore të autorizuarit të paditurës, por të njëjtat ishin të pa bazuara dhe nuk patën ndonjë ndikim që gjykata të vendos sipas propozimit ankimor, përkatësisht ta ndryshoi aktgjykimin e atakuar sa i përket lartësisë së gjykuar, siç ka pretenduar e paditura.

Sipas Gjykatës së Apelit, të gjitha këto që u cekën në dispozitat e sipër cekura ligjore, gjykata e shkallës së parë i ka pasur parasysh me rastin e marrjes së aktgjykimit të atakuar, kur ka vendosur që ta aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e Apelit po ashtu vlerëson se lidhur me dëmin material të shkaktuar paditësit, si pasojë e këtij aksidenti, gjykata e shkallës së parë me të drejtë paditësit i ka caktuar edhe kamatën përkatëse ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 382 të LMD-së. Krejt në fund gjykata e shkallës së parë, po ashtu drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar edhe kërkesën e palës paditëse, për shpenzimet e procedurës kontestimore të përshkruar në pjesën arsyetuese të aktgjykimit të atakuar e duke gjetur mbështetje në dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së.

Po ashtu, Gjykata e Apelit vlerëson se, shumat e aprovuara janë të arsyeshme dhe konform mendimit profesional të ekspertit të makinerisë, për rastin konkret dhe në këtë drejtim nuk ka vend për zvogëlim të këtyre shumave, siç pretendohet në ankesën e të paditurës, sepse gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka marrë në përputhje të plotë me ekspertizën e makinerisë dhe gjendjen faktike të vërtetuar paraprakisht.

Prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje, si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës.

Meqenëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, dhe nuk ekzistojnë shkelje esenciale për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, sipas nenit 194 të LPK-së, konform dispozitës së nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, NË PRISHTINË
Ac.nr.6422/2020 me dt.29.07.2021

Kryetari i kolegjit-gjykatësi
Gëzim Lulluni